



BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ÇERDHEVE DHE KOPSHTEVE

PROGRAMI I EDUKIMIT PËR FËMIJËT 6-18 MUAJ
MUAJI SHKURT



PËR STAFIN EDUKATOR TË ÇERDHEVE PUBLIKE TË TIRANËS

<http://femijetetiranes.al/>

Kuriozitete për Muajin Shkurt



Çfarë duhet të dime për muajin Shkurt?

- **Shkurti** është muaji i fundit i stinës së dimrit dhe muaji i dytë i vitit.
- Muaji Shkurt quhet i tillë, sepse është muaji me më pak ditë i vitit.
- Muaji Shkurt ka 28 ditë dhenjëherë në katër vjet ka 29 ditë. Viti ku muaji Shkurt ka 29 ditë është i njohur dhe si “Viti i Brishtë”.
- Në muajin Shkurt fillojnë të çelin lulet e para të pranverës si: lule mimoza, manushaqja, lulja e qershisë etj.




Grupmosha e fëmijëve: 6-18 muaj

- ✚ **Java I:** Bota e përrallave.
- ✚ **Java II:** Personazhet më të dashur të përrallave.
- ✚ **Java III:** Bota e kafshëve përmes përrallave.
- ✚ **Java IV:** Teatri i kukullave.

Tema mujore: “Përrallat dhe personazhet e tyre”		
Temat Javore	Qëllimi	Koha e realizimit
Bota e përrallave.	Njohja e fëmijëve me botën e përrallave dhe personazhet kryesorë të tyre.	Java I
Personazhet më të dashur të përrallave.	Njohja me përrallat klasike, shqiptare dhe ato të reja. Emocionet që përjetojmë kur lexojmë përralla dhe njohja me veshjet e personazheve.	Java II
Bota e kafshëve përmes përrallave.	Njohja e kafshëve përmes përrallave: kafshët shtëpiake, kafshët e pyllit, bota ujore dhe e insekteve	Java III
Teatri i kukullave.	Njohja me teatrin e kukullave.	Java IV

Tema mujore: “Përrallat dhe personazhet e tyre”


Tema javore : “Bota e përrallave”



Java I	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
<p>E Hënë</p>	<p>Njohja me botën e përrallave</p> 	<p>Bisedë: Edukatore- Fëmijë. Edukatorja i’u tregon fëmijëve libra, revista me përralla, duke emërtuar personazhet kryesor të përrallave.</p> <p>Aktivitet : “Libri që tregon për mua” Edukatorja krijon një libër me fotot e fëmijëve. Realizohet me fëmijët 12-18 muajsh.</p> <p>Kënga : “Qingji i vogël”</p>	<p>-Mjete didaktike: disa blloqe bosh, ngjitës, fotografi të fëmijëve (të përgatitura paraprakisht, në bashkëpunim me prindërit)</p> <p>-Manuali i vjershave /këngëve</p>
<p>E Martë</p>	<p>Personazhet e përrallave</p> 	<p>Bisedë: Edukatore- Fëmijë. Edukatorja i’u tregon/ ilustron fëmijëve një përrallë përmes arushave ose kafshëve, duke imituar tingujt e tyre: ciu-ciu, mjau-mjau, be-be. Ky aktivitet mund të shoqërohet me libra me tinguj,të cilat fëmijët mund t’i prekin.</p> <p>Përralla : Leximi i përrallës “Tre Derrkucët ”</p> <p>Aktivitet: Futja e rrathëve në kon.</p> <p>Kënge lëvizore : “Duart nga e majta ”</p>	<p>Manuali i vjershave/ këngëve</p> 
<p>E Mërkurë</p>	<p>Librat</p>	<p>Bisedë:Edukatore-Fëmijë. Edukatorja i’u ilustron fëmijëve përmes figurave të librave,</p>	<p>-Manuali i vjershave/këngëve</p>

		<p>personazhet kryesore të përrallave. Edukatorja emërton personazhet kryesore: ma-cja , qe-ni, zo-gu; duke imituar tingujt e tyre: mjau-mjau, ham – ham, ciu-ciu ...etj</p> <p>Aktivitet : Libri i ngjyrave. Edukatorja me ndihmën e fletëve me ngjyra formon një libër dhe bën emërtimin e ngjyrave duke i’u kërkuar fëmijëve t’i tregojnë ato me gisht . Të përdoren ngjyrat bazë:e kuqe, blu, e gjelbër.</p>	<p>-Mjete didaktike:Kukulla, arush etj</p>
<p>E Enjte</p>	<p>Gjumi dhe përrallat</p> 	<p>Bisede: Edukatore-Fëmijë. Edukatorja i’u lexon fëmijëve një përrallë para gjumit, që fëmijët të bëjnë gjumë të qetë.</p> <p>Aktivitet: Vendosja e kukullës në gjumë (Loja “bëj sikur”) shoqëruar me vjershën Nina-nana kukulla.</p> <p>Lojë: Ndërtojmë me kuba (të përdoren ngjyrat kryesore: e kuqe, e verdhë, blu, e gjelbër)</p> <p>Kërcejmë: Këngë për fëmijë.</p>	<p>-Manuali i vjershave dhe këngëve.</p> <p>Mjete didaktike</p> <p>Kuba me ngjyra, kukulla.</p>
<p>E Premte</p>	<p>Përsëritja e aktiviteteve javore</p>	<p>Përsëritje e aktiviteteve të realizuara gjatë javës.</p> <p>Këngë lëvizore: “Nëse ti je i gëzuar”</p>	<p>-Manuali i vjershave/ këngëve.</p> <p>-Manuali i lojrave</p>

Tema mujore: “Përrallat dhe personazhet e tyre”

Tema javore: “Personazhet më të dashur të përrallave”



Java II	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
E Hënë	<p>Përrallat klasike</p> 	<p>Bisedë: Edukatore- Fëmijë. Edukatorja interpreton një përrallë duke imituar personazhe të ndryshme, me intornacionin e duhur në mënyrë që të tërheq vëmëndjen e fëmijëve.</p> <p>Edukatorja së bashku me fëmijët emërtojnë personazhet që janë në libër.(12-18 muajsh)</p> <p>Përralla: Leximi i përrallës “Lepuri dhe Breshka” në grup.</p> <p>Këngë : “Familja e gishtave ”</p>	<p>-Manuali i vjershave/këngëve</p> <p>-Mjete didaktike: libra me përralla</p>
E Martë	<p>Përrallat e reja</p> 	<p>Bisedë: Edukatore fëmijë. Edukatorja i’u tregon fëmijëve arusha pellushi duke i’u shpjeguar karakteristikat e secilit. (Ky arush ka ngjyrë të kuqe, blu, të gjelbër, për disa nga arushat që kanë në grup).</p> <p>Aktivitet : Leximi i përrallës “Derrkucja Pepa”.</p> <p>Edukatorja j’u tregon fëmijëve pjesët e trupit të Derrkuces Pepa (12-18 muajsh).</p>	<p>Manuali i vjershave/këngëve.</p>

		Këngë: “Nëse ti je i gëzuar”	
E Mërkurë	Përrallat shqiptare me kafshë 	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë. Edukatorja i’u tregon fëmijëve kafshë prej lodre, të cilat mund ti prekin, duke përsëritur pas edukatores emrat ose tingujt e kafshëve.</p> <p>Edukatorja i tregon fëmijëve karakteristikat e kafshëve (12-18 muajsh).</p> <p>Aktivitet: Vendosja e kukullës në gjumë (Loja “bëj sikur”) shoqëruar me vjershën Nina-nana kukulla.</p> <p>Lojë: Futja e pipave në shishe plastike (koordinimi dorë-sy).</p>	-Mjete didaktike: kafshë lodre -Manuali i vjershave/këngëve
E Enjte	Përrallat shqiptare me personazhe. 	<p>Aktivitet. Edukatorja i’u lexon fëmijëve përrallën e “Pipirukut” dhe ju kërkon fëmijëve të kthejnë faqen e librit së bashku.</p> <p>Edukatorja i nxit fëmijët të përsërisin pas saj fjalët që ajo ju lexon dhe ju tregon me gisht në libër (12-18 muajsh)</p> <p>Kënga : “Pipiruku” lëvizje energjike shoqëruese të këngës.</p>	-Manuali i vjershave /këngëve -Mjete Didaktike : Lodra të ndryshme të kësaj grup-moshe.

E Premte	Përsëritje e aktiviteteve javore	Përsëritje e aktiviteteve javore . Këngë lëvizore : “Plaku Donald ka një fermë”	-Manuali i vjershave/ këngëve Libra me përralla .
-----------------	----------------------------------	--	---

Tema mujore: “Përrallat dhe personazhet e tyre.”

Tema e javës: “Personazhet më të dashur të përrallave”


Java III	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
E Hënë	Kafshët shtëpiake 	Bisedë: Edukatore-fëmijë. Edukatorja i’u flet fëmijëve për kafshët shtëpiake duke i treguar kafshë prej lodre dhe imiton tingujt e tyre. Vjersha: “Rosat po lahen” Aktivitet: Krijojmë liqenin dhe rosat nëpërmjet mjeteve të riciklueshme (si në foto).	-Mjete didaktike : Libra/revista me kafshë,qese, letra me ngjyrë jeshile, rosakë lodre. -Manuali i vjershave/ këngëve. 
E Martë	Kafshët e pyllit	Bisedë: Edukatore-fëmijë Edukatorja i’u flet fëmijëve për kafshët e pyllit duke i treguar ato në figurat e librave apo revistave duke nxitur fëmijët	-Manuali i vjershave/ këngëve

		<p>t'i tregojnë ato me gisht.</p> <p>Vjersha:“Bubi i vogël”</p> <p>Loja: Roza-rozina.</p>	
<p>E Mërkurë</p>	<p>Bota ujore</p> 	<p>Aktivitet: Improvizojmë një akvarium në një enë plastike ose në një kuti kartoni, vendosim gjallesa të ndryshme të botës ujore. Nxsim fëmijët të kapin gjallesat (peshqit, delfinët, breshkat e uji etj).</p> <p>Vjersha:“Rosaku”.</p> <p>Këngë lëvizore: “Duart nga e majta”.</p>	<p>-Manuali i vjershave/ këngëve.</p> <p>-Mjete didaktike: Enë plastike, kuti kartoni.</p>
<p>E Enjte</p>	<p>Bota e Insekteve</p> 	<p>Aktivitet 1:Edukatorja demonstron tingujt e insekteve të ndryshëm, shoqëruar me lëvizjen e krahëve (bleta bën bzz-bzz, miza bën zzz-zzz).</p> <p>Aktivitet 2: Krijimi i insekteve me duar, këmbë dhe gishta të fëmijëve.</p> <p>Pasi edukatorja j’u ka ngjyrosur duart me penel me bojë, vendosim gjurmët e duarve të fëmijëve në letër.</p> <p>Kënga: “Bubrreci”</p>	<p>Manuali i vjershave/ këngëve</p> 

E Premte	(Loja më e bukur për mua)	Përsëritja e / këngë lëvizore / lojëra të lira.	Manuali i vjershave/këngëve.
-----------------	---------------------------	---	------------------------------

Tema mujore: “Përrallat dhe personazhet e tyre.”

Tema javore “Teatri i kukullave”

Java IV	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
E Hënë	<p>Një shfaqje me animator</p> 	<p>Aktivitet: Edukatorja i’u tregon fëmijëve duke i ilustruar me foto animatorë të ndryshëm.</p> <p>Kënga: “Nëse ti je i gëzuar”</p> <p>Loja: Kutia e formave, edukatorja ndihmon fëmijët të identifikojnë format e ngjashme dhe t’i fusin në kuti.</p>	<p>-Manuali ivjershave</p> <p>-Mjete Didaktike: Set lodrash</p> 
E Martë	Teatri kukullave	Aktivitet: Edukatorja improvizon një shfaqje duke përdorur kukulla të ndryshme (prej pellushi).	-Manuali i vjershave /këngëve. - MjeteDidaktike: Set

		<p>Vjersha: “Lepurushi”</p> <p>Loja:“Tullumbacja që jep tinguj” (Sqarimi: Në një tullumbace të fryrë të kuqe ose blu, hedhim brenda kokra orizi, edukatorja lëviz tullumbacen, për të dëgjuar tinguj të ndryshëm).</p>	<p>lodrash prej pellushi, oriz, tullumbace me ngjyra.</p>
<p>E Mërkurë</p>	<p>Kafshët dhe tingujt</p> 	<p>Bisedë: Me anë të tabelës së lotos ilustruamë kafshët me figura, duke i nxitur fëmijët të përsërisin tingujt e kafshëve.</p> <p>Këngë: “Tingujt e kafshëve ”</p> <p>Vjersha: “Rosaku”</p>	<p>-Manuali i vjershave/ këngëve.</p> <p>-Mjete didaktike: Kafshë të ndryshme lodra.</p>
<p>E Enjte</p>	<p>Këngë dhe lojra</p> 	<p>Aktivitet: Me ndihmën e edukatoreve formojmë me brumë forma të ndryshme.</p> <p>Këngë: “Bubrrëci”</p> <p>Këngë: “Treni”</p> <p>Lojëra energjike: “Kukafshehti”. Fshihni topin nën batanije, pyesni fëmijë: “Ku është topi?”</p> <p>Për të nxitur vetëdijësimin e vazhdimësisë së objektit.</p>	<p>-Mjete didaktike : top</p> <p>-Manuali i vjershave/ këngëve</p>

E Premte	Aktivitet i lirë	Aktivitet: Tregimi i një përralle (zgjedhja e lirë nga edukatorja). Aktivitete të lira.	Mjete didaktike: libra me përralla.
-----------------	------------------	--	-------------------------------------